

Hapet Thirrja për Aplikime për Bursa Mobiliteti për Shkollën Verore në Universitetin Radboud, Hollandë, në Kuadër të Programit Erasmus +, për Studentët e PhD të cilët janë njëkohësisht edhe staf të Universitetit të Tiranës.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për shkollën verore për studentët e PhD të cilët janë njëkohësisht edhe staf të Universitetit të Tiranës në Universitetin Radboud, Hollandë.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të PhD të cilët janë njëkohësisht edhe staf i Universitetit të Tiranës.

Kohëzgjatja e bursave:

- Mobiliteti për trajnim (5 ditë + 2 ditët e udhëtimit)

Fushat e mobilitetit:

Info mbi shkollën verore në Universitetin Radboud:
<http://www.ru.nl/radboudsummerschool/courses/all-courses/>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimi ditor (160 EUR në ditë);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin Doktoraturë:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash të studimeve të doktoraturës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj angleze (niveli B2);
- Plani i mobilitetit për trajnim*;

**Mobility Plan është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen gjatë periudhës së mobilitetit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus + Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf

Afati për aplikime: 13 Mars 2017

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt: “Aplikim për bursë në Universitetin Radboud, emrin dhe mbiemrin tuaj”.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën:
iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!